KRONIKË E ZEZË

Plagoset një person në Rahovec nga të shtënat me armë në një aheng familjar



Foto: Illustrim

30 dhjetor 2022, 08:56

Shpërndaje në

Një person është plagosur të enjten në mbrëmje në fshatin Dobidol të Rahovecit, si pasojë e gjuajtjes me armë nga një person tjetër në një aheng familjar.

Policia e Kosovës ka bërë të ditur të premten se lidhur me këtë rast ka arrestuar një 54-vjeçar nën dyshimin se ka gjuajtur me armë zjarri gjatë ahengut.

Ndërkaq, viktima është duke u trajtuar edhe më tutje në Spitalin e Gjakovës për shkak të plagës nga një predhë e plumbit.

"Stacioni Policor në Rahovec pasi kishte pranuar informatë për të shtëna me armë zjarri në fshatin Dobidol-Rahovec, iu janë përgjigjur rastit dhe kanë arrestuar të dyshuarin N.M., mashkull, shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në vitin 1968, i cili dyshohet se rreth orës 23:00 në një aheng kishte shtënë me armë zjarri. Nga të shtëna dyshohet se aksidentalisht është qëlluar një person, mashkull i moshës madhore i cili vazhdon të trajtohet në Spitalin Rajonal të Gjakovës për shkak të plagës së shkaktuar nga një predhë e plumbit. Në cilësinë e provave materiale është konfiskuar një pistoletë prodhim turk me një karikator dhe katër gëzhoja të kalibrit 9mm.

I dyshuari është ndaluar për 48 orë me vendim të prokurorit.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#GJUAJTJE ME ARME ZJARRI #PLAGOSJE #RAHOVEC

Kapet një kosovar në portin e Durrësit duke tentuar t'i kontrabandonte qindra paketa cigaresh
Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarit për shitje të shtëpive që ishin të shitura
Sulm ndaj katër policëve në Prizren
Aktakuzë ndaj tetë personave lidhur me sulmin ndaj djalit të Nenad Rashiqit
Në Prizren babai denoncon djalin për dhunë në familje
Leposaviq, një person raporton se dy të maskuar e kanë sulmuar dhe ia kanë hequr targat
KFOR-i dhe FSK-ja asgjësojnë një granatë në Samadraxhë

Taboola Feed



Hair transplant can be cheaper than you think
Hair Transplantation | Search Ads | Sponsored



Laser Liposuction in Mexico Cost Might Surprise You.
Liposuction Cost | Sponsored



Mërgimtarit që s'erdhi në Kosovë për 5 vjet iu vodh gjithçka, arrestohet i dyshuari
Policia e Kosovës ka njoftuar se në Pejë ka arrestuar një të dyshuar për vjedhje të rëndë. Sipas njoftimit të Policisë I.B., 39-vjeçar, dyshohet se ka vjedhur gjithçka në shtëpinë e një …
Kohanet

These neuropathy socks are taking our country by storm
CareSocks | Sponsored

TË TJERA

I burgosuri arratiset nga vetura me të cilën po transportohej për në gjykatën e Gjakovës

Zhvilloi shpejtësi gati trefish më të lartë se e lejuara, i ndalohet ngasja e automjetit për një vit

Një 45-vjeçari nga Istogu i sekuestrohen 59.100 euro nga Policia e Shqipërisë

Dëshmitari: Në banesën e Krivaqës kam shkuar për t'i kthyer kamerat 5-6 ditë prapa e jo për t'i fshirë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.